



Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit

EKSKURZIONI 2004

Përshkrimi i tekstit: Zaim Ibrahim
Korrektura: mr. Bekim Alimi
Foto: Hikmet Selami
Boton: Qendra Islame – Wil

Islamischer Verein – Titlisstrasse 3a 9500 Wil
Tel: 071 912 26 98; Email: iz.wil@bluewin.ch

Parathënie

Çdo falenderim dhe lëvdatë është për Allahun Një, Zot të vetmin e të pashoqin, që krijoi dhe furnizoi dhe askuj padrejtësi nuk i bëni. Salatet dhe selamet janë për të dërguarin tonë Muhamed a.s. rrob dhe i dërguari i Allahut.

Kjo xhami është nën shërbimin e muslimanëve dhe të Islamit dhe mu për këtë shkak tenton koh pas kohe të paraqitet me kësi organizimesh, gjë që bën me dije se edhe fëmijët tanë kanë një institucion i cili meret me plotësimin dhe përmbushjen e dëshirave të tyre.

Nga këto aktivitete që e tërheqin të riun tanë janë gara në dituri për muajin e madh të ramazanit, turniri në futboll dhe aktivitete sportive, këndimi i ilahive dhe recitimi poezive të ndryshme në ditëne e madhe të bajramit dhe kjo e cila sot po përshkruhet nga ne, shëtitja nëpër xhami të zvicrës e më larg.

Strategjia ynja është ajo e cila na mëson islami, që të përdorim motivimin dhe tërheqjen për ka rruga e Allahut xh.sh.

Shpresojmë që përmes këtij mudi sadoqoft i vogël që t`iu kontribojmë muslimanëve dhe Islamit, qëllim të cilin e synojmë.

Allahu qoft i kënaqur

mr. Bekim Alimi

Rruga për në Genevë Ekskurzioni 2004

Pas agimit mora abdest për të iu drejtuar Allahut Zotit të gjith botërave.

Edhe sot lindi dielli në lindje siç edhe lind çdo ditë por unë tepër u gëzova prej kur e kam lexuar një hadith që tregon për shenjat e mëdha që paralajmëron ditën e fundit (kijameti) mua mu dha shpresa edhe për 24 orë të ardhura që nuk do të ndodhë dita e kijametit.

Filluam me përgatitjen e udhëtimit me, imamin, magjistrin Bekim ef. Alimin, edhe pse i zbehur në fytyr me shenja të lodhshme trupore, pagjumësi etj, por me vullnet dhe ide të panumërta. Filluam me një përgatitje detale për një ekskurzion në një drejtim me gjatësi prej afro 800 km.

Këtë udhëtim guxojnë ta përjetojn nxënësit që ndjekin msim besimin fetar pranë Xhamis në Wil. Duke filluar me brengën e ushqimit të fëmijëve dhe blerjen e lëngjeve, listave me emra dhe mbiemra të evidentuar.



Në këto çaste aritën edhe dy autobusat nga Alpina Reisen. Me shokët e tij: h. Shefik Xheladini, Zaim Ibrahimi, Hikmet Selami, Xhulijan Tefiku, Besim Farizi, Alireshat Ismani dhe Sadush Elmazi, dhe një tubim i pashembullt i nxënësve së bashku me prindërit e tyre dhe me fytyra të zbehura dhe buzëqeshura e të hareshme, hypën në dy autobusat që pritnin. Mund të paramendosh sikur bletët që mblidhen rreth hojeve të të tyre.

Pasi që konstatuam arritjen e nxënësve sipas evidencës, filluam udhëtimin tonë të planifikuar për vizitë të një Xhamie me minare në Genevë, për arsye se nxënësit nuk kanë parë xhami të tillë. Nisja nga xhamia e Wil-it u bë në ora 7:30h .

Në autobusin numër 1 ishin prezent gjithsejt 36 nxënës, 4 persona të mëdhenjë dhe shoferi Zulqufliu. Në autobusin numër 2 ishin prezent gjithsejt 30 nxënës, 4 persona të mëdhenjë dhe shoferi Gajuri.

Drejtimi i udhëtimit:

Nisja prej Wil – Zürich – Bern –
Lausanne – Genèvë.

Kthimi prej Genèvë – Bern –
Biel Bienne – Zürich – Winterthur - Wil.



Koha gjatë tërë udhëtimit ka qen me të reshura të dobta të shiut.



Ndalje në parking për ndarje të ushqimit në autobusin e dytë 7:50h dhe nisje.

Pushim në një pompë të benzinës në afërsi të Olten-it prej ora 9:15h – 9:40h, këtu bëmë disa fotografi me nxënësit, vazhdim i rrugës, përsëri një pushim të vogël në vendin e quajtur Aubone prej ora 11:25h – 11:35h në parking për rreth rrugës.

Arritja pran Qendrës Islame në Genèvë në ora 12:00h. Fillimi i kësaj xhamie ka qen në vitin 1975, ndërsa xhumaja e parë është falur në vitin 1978. Qëllimi i ndërtimit të kësaj xhamije për kryerjen e obligimeve fetare të gjith muslimanëve që jetojnë në



këtë qytet pa marrur parasysh se cilit entitet i takojnë, njashtu për vizitë mund të vijnë të gjithë popujt e botës. Udhëheqësi ynë na citon ajetin për ndërtimin e xhamive...



Në brendinë e xhamisë kemi mësimdhënës për gjuhën arabe për ata që dëshirojnë të flasin gjuhën arabe, kemi mektebe me një numër të nxënësve afro 700. Përbëhet prej dy pjesëve, të asaj që është ndërtuar më parë pjesa e vjetër dhe zgjerimi i pjesës së re.

Kemi një salon për mbledhje ku plafoni i saj na fascinoi me mozaikun e pllakave të vogla që qartas tregonin kaligrafjin e sures Ihlas, mund ta vëreni në fotografjin që e bëmë.

Kemi poashtu bibliotekën të pajisur me libra ku mund të lexoni dhe të hulumtoni lëmi të ndryshme. Kemi një laborator të pajisur me vegla teknike për lehtësimin e përvetësimit të gjuhës arabe për ata të cilët nuk flasin arabisht. Këtu do të bëhet një shkollë për imam dhe mualim në gjuhën arabe, frenge, germane dhe angleze, ku do të kenë mundësi burra e gra të edukohen.



Kemi një restoran i cili bëhet aktual vetëm gjat muajit të shenjtë të ramazanit por edhe për solemnitete të ndryshme siç është synetimi i fëmijëve, kurorëzimi etj. Ja pra pran juve është një shkollë për nxënësit e Pakistanit e cila spjegohet në gjuhën e tyre.



Për bajram në mesxhid falen afro 7000 persona. Xhamija është në formë të tetraedrit (tetëkëndësh) brendësin e përbënë mozaiku i shpesht dhe i imët, arabeskat, mahfili ku është mjaft i ngritur dhe ka hymje të veçant, llusteri po ashtu në form tetraedri dhe prej kristalit punik ky që e kanë përgatitur

mjeshtrit nga Italia dhe ka kushtuar afro 100 000 sfr.

Në brendësin e xhamis ka të instaluar edhe dy projektor të cilët e interpretojnë hutben apo imamin direkt. Flitet se i tër objekti ka kushtuar afro 14 mil sfr.

Pas vizitës detale të tër objektit falëm dy rekate te hijetull mesxhid dhe në ora 12:55h u nisëm për në qytetin tjetër Biel Bienne.

Në stacionin e trenit të qytetit Biel Bienne arritëm në ora 15:07h dhe menjëher u drejtuam kah restorani i vëllezërve Asani (Naser, Besim, Muzafer dhe Agim) të cilët posedojnë 3 pizzeri prej tyre dy në këtë qytet dhe një në Bern dhe një kafeteri në brendin e Migros.



Deri në ora 17:00h të gjithë ngrënëm drek me nga një pizza të madhe dhe të begatshme njëashtu edhe lëngje freskuese dhe morëm rrugën për një Winterthur për vizit të xhamis.

Bëmë një ndalje të shkurtër në xhamin e këtij qyteti (Biel, imam i këtij mesxhidi është Gani Misini) deri sa e falëm namazin e drekës. Në ora 17:20h u nisëm për në rrugë.

(në ora 18:20h gjatë udhëtimit në veture i ranë shkallët e aluminit dhe në një skaj të vogël i ran autobusit numër dy ku u ndalëm por nuk ishte gjë e madhe mirëpo sipas rregullave i lajmëruam policët e komunikacionit dhe për 10 minuta arritën ku e bënë fotografimin dhe e zunë personin që i kishin ra shkallët Lkw regj. AG-415 090)



Arritëm në xhaminë e Winterthurit në ora 19:40h falëm namazin e ikindis dhe pasi që i bëmë disa fotografi dhe e viziutam tër objektin dhe na njoftuan se hapja solemne e kësaj xhamie do të bëhet javën e ardhshme 15.05.2004.

Blerja e objektit në fjalë ka kushtuar 320 000 sfr. Ndërsa konstrukcioni i kupollës ka kushtuar afro 50 000 sfr. Në pjesën e prapme të xhamisë ndodhet mahfili i ngritur në shtylla që don të thot se edhe grat kanë mundësi të vinë dhe të luten, hyrja për gra është apostafate.

Pastaj kemi një klasë për mekteb dhe një zyre të vogël për imamin dhe abdest`hanja e grave. Kurse në anën tjetër hyrje për burra dhe abdest`hane në vete, po ashtu kemi edhe një kafeteri të vogël.



Llusteri është me një elektromotor i cili mund të lëshohet për tu pastruar dhe për tu ndruar llambat i cili na kushtoi afro 5700 sfr. Kthimi filloi në ora 20:10h për në Wil.



Gjatë kthimit kemi kënduar ilahi së bashku me imamin kjo e fundit i bëri nxënësit edhe më të lumtur kështu që kur arritëm në Wil pamë fytyrat e hareshme dhe të buzëqeshura nga lumturia që sot e përjetuan nxënësit dhe për fund falënderojmë Allahun e Lartmadhërishëm që na e mundësoi këtë udhëtim të gjatë dhe të këndshëm pa probleme dhe incidente dhe u kthyem shëndosh e mirë ku pasi që arritëm pran xhamis pamë se ishin duke pritur prindërit me padurim fëmijët e tyre dhe menjëher filluan pyetjet se si e keni kaluar këtë ditë pushimi.

Arritëm në ora 20:40h falëm namazin e akshamit dhe diskutuam rreth angazhimeve të cilat duhet marrë në të ardhmen.

Përshtypjet e nxënësve nga shëtitja:

Nxënëse

Mua më ka pëlqyer që ishim dhe e pamë xhaminë e re në Wintethur. Pak më pak më ka pëlqyer, që duheshte të presim në Autoban.



Nxënëse

Mua më ka pëlqyer shëtitja shumë. Në restorant ishte shumë mirë. Diçka që nuk më pëlqeu ishte pse ushqimin nuk e pranua pak më herët.

Nxënëse

Selam Alejkum

Mua më ka pëlqyer dreka, xhamia në Winterthur dhe xhamia në Zhenevë. Mua më kanë pëlqyer vikat që na i refeu hoxha apo më mirë me thënë e tërë shëtitja. Qëndrimi në autobahn ishte pak i mërzitshëm.



Hoxho, a ju ka pëlqyer edhe juve?

Nxënëse

Ishte bukur!

Artan

Shëritja ishte e bukur, çka nuk më pëlqeu, hoxha në rëfeu pak vica. Ushqimi në Autobus ishte i mirë dhe ideja që në Autobus të meret ushqim e shoh une të bukur. Dreka ishte poashtu bukur!



Zirafete



Unë personalisht e kam gjetur shumë bukur në fillim mendova se do të jetë shumë e bezdisur sepse unë kam qenë një herë në Gjenevë dhe në Bern, Ok në Winterthur jo por kjo nuk do të ishte shumë diçka e re. Por në të kundërtën u mahnita kur e pash se aq bukur kaluam gjë të cilën ndoshta kurr nuk do ta

harrojë. Unë dëshiroj që gjithmon të ndërmiren kështu organizime të bukura. Kjo ishte një ide vërtet e bukur. Super 😊 respekt për të gjithë ata që e organizuan.

Nora

Prej Wilit e deri në Gjenevë kanë zgjatur katër orë e gjysëm. Ishte shumë bukur dhe me Hoxhën ishte kënaqësi apostafate! Mirëpo kur shkante Hoxha në autobusin tjetër shoferi qortoheshte!!! Xhamia në Gjenevë ishte shumë e bukur dhe e madhe dhe kishte libra, në pizzeri kishte pizza të mëdhaja, koka kola e Negrinës u derdh por nuk u kuptua se kush e bëri këtë.

Autobusi ishte shumë i madh, në Winterthur kishin poashtu Xhami shumë të madhe.



Vicat ishin cool. Gentiana kishte një rastë qesharak me të cilën kishim kënaqësi të madhe.

Dafina

Mirdita Hoxhë mua më pëlqeu shetitja në Genevë dhe në të gjitha vendet që i vizituam.

Pizza ishte shumë e mirë dhe vizitat ishin shumë të mira.

Anonime

Çka gjeta shumë bukur ishte pizza, vicat me Hoxhën dhe Ilahitë. Çka nuk më pëlqeu ishte qëndrimi në autoban përshkak të një defekti në autobusin e parë. Për ndryshe ishte krejt cool.

Anonim

Unë e kam gjetur mirë, falenderit për pizzën dhe për vicat që ishin shumë të mirë.

Anonim

Unë e gjeta shumë mirë, Xhamiat ishin të bukura, pizza ishte e shkëlqyer. Unë falënderoj stafin për pizzën dhe shpresoj që të më bëjnë edhe një shetitje të tillë.

Anonime

Mua më pëlqen shetitja që ishim me shoqe dhe me shokë. Falënderit që na keni lexuar ilahije dhe përalla. Unë i përshëndes fëmijët dhe burrat që ishin me ne. Edhe e përshëndes shoferin që na ka vozitur mirë. Edhe restoranti edhe Xhamiat ishin shumë të mira.

Anonim

Dita e djeshme më ka pëlqyer shumë. Në mëngjes kur arritëm në Genevë dhe kur shkuam në Xhaminë e saj e cila ishte shumë e madhe. Kur u kthyem për në shtëpi rrugës duke udhëtuar me autobus më ka pëlqyer shumë se ju (Hoxha) na keni treguar shpjegime dhe këndonit ilahija.

Anonim

Mua më ka pëlqyer Xhamia e parë më së shumti, dhe llusteri i saj. Gjatë rrugës ka qenë kënaqësi.

Jusuf

Ishte bukuri, pizza ishte e këndshme, Xhamia ishte shumë e bukur, vozitja gjat rrugës ishte përjetimi më i bukur.

Ujmire

Mua më pëlqeu gjat rrugës sepse djemt bënë gjëra qesharake. Xhamia në Genevë ishte shumë e bukur posaqërisht llusteri i saj. Xhamia e dytë më pëlqeu më shumë sepse ajo ishte e përpunuar nga mermeri. Kur u afruam Wilit fillova të mërzitem sepse kënaqësia ishte kah përfundon.

Pajtim

Xhamia në Winterthur ishte e bukur. Mua më pëlqeu se të gjithë ishin të kënaqur. Pizza ishte shumë e mirë dhe më pëlqeu që Hoxha bënte vica.

Anonime

Mua më pëlqen që ishim në Genevë, edhe unë i përshëndes fëmijët dhe shoferin dhe të gjithë që ishin me ne.

Kumrije

Shetitja ishte fantastike vërtet më ka pëlqyer shumë inshaallah do të kem rastin të përjetoj edhe një herë një shetitje të tillë. Falënderit që na more me vete Allahu të bekoft.

Përgaditi:

Zaim Ibrahimimi dhe Bekim Alimi